

Letër mbështetëse për aktivisten Shpresa Loshaj

Ne, organizatat dhe aktivistët e poshtëshënuar, shprehim mbështetjen tonë për aktivisten Shpresa Loshaj e cila, për shkak të akvizimit të saj në mbrojtje të ujërave, është duke u ballafaquar me padi për 'dëmtim' të imazhit.

Përgjatë vitit të fundit, Loshaj ka dokumentuar degradimin e natyrës në Deçan dhe ka kritikuar kompaninë Kelkos për mënyrën e shfrytëzimit të ujërave natyrorë. Ajo i është drejtuar me letra institucioneve publike dhe ka ngritur zërin e saj përmes paraqitjeve në media dhe në rrjete sociale.

Për shkak të aktivizmit të saj, "Kelkos Energy" sh.p.k. ka paditur Loshajn dhe kërkon nga ajo 100,000 euro dëmshpërblim; të tërheqë deklaratat 'shpifëse', të kërkojë falje publike ose të shprehë pendim publik dhe në të ardhmen të përmbahet nga përhapja e deklaratave të 'pavërteta' kundër Kelkosit.

Ne e konsiderojmë këtë si *Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP)* që synon heshtjen dhe frikësimin jo vetëm të të paditurës, por të secilit aktivist që guxon të shprehet lirshëm dhe të kritikojë kompanitë që përfitojnë nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të Kosovës.

Padia SLAPP është bërë më 1 qershor 2020 nga avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, ndërsa lënda pritet të gjykohet nga gjykatësi Nexhat Musaj në Gjykatën Themelore, dega në Deçan. Loshaj është njoftuar për padinë më 16 shkurt 2021.

Ne kërkojmë nga kompania KELKOSS Energy Sh.P.K (*me numër identifikues 810796005*) që pa vonesë të tërheqë padinë SLAPP kundër Loshajt. Zvarritja e Loshajt nëpër gjykata për pretendime të pabazuara nuk do ta dekurajojë atë nga aktivizmi i saj.

Shpresa Loshaj është një ndër aktivistet më të zëshme në fushën e mbrojtjes së ambientit, e cila vazhdimisht ka reaguuar ndaj degradimit të mjedisit përmes ndërtimit të hidrocentraleve të reja pa plotësimin e kushteve, si dhe për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për dëmet që i shkaktojnë ndërtimi i këtyre hidrocentraleve në mjedis. Falë saj dhe aktivistëve të tjerë në Deçan, publiku është informuar për degradimin që po i bëhet ambientit në Deçan.

Vitin e kaluar, e njëjta kompani ka ushtruar [padi SLAPP edhe ndaj aktivistit Adriatik Gacaferi](#). Kompania pretendon që një foto e shoqëruar me një koment kritik dhe e publikuar nga Gacaferi më 1 nëntor 2019 në llogarinë e tij private në Facebook, ja ka dëmtuar reputacionin. Kompania kërkon nga Gacaferi: *10 mijë euro dëmshpërblim, largimin e statusit nga Facebook dhe publikimin për 12 muaj të një deklaratë mohuese të atij statusi*

Qëllimi i padive SLAPP është që të pengohet kritika dhe pjesëmarrja e aktivistëve në procese publike dhe po që se do të ishin të suksesshme në gjykatë, këto padi do të përbënin kërcënim të demokracisë dhe të drejtës së lirisë së shprehjes së aktivistëve. Prandaj ftojmë aktivistët dhe gazetarët që të mos dekurajohen nga këto padi dhe të vazhdojnë të përkushtohen e të sigurojnë mbështetje dhe ndihmë praktike për të gjitha viktimat e padive SLAPP.

Informacion shtesë rreth padive SLAPP

Vitet e fundit është paraqitur një trend negativ i përdorimit të këtyre padive, të ashtuquajtura SLAPP (*Strategic Lawsuits Against Public Participation*). Politikanët dhe biznesmenët e fuqishëm, duke e ditur që nuk kanë bazë dhe shans për sukses, kërkojnë nga gazetarët, mediat dhe aktivistët qindra mijëra e deri në miliona euro dëmshpërblime në emër të prishjes së imazhit apo “cenimit të reputacionit”.

Paditë SLAPP janë padi që prima facie vërehen se nuk janë të bazuara në fakte dhe se do të jenë të pasuksesshme në gjykatë. Përmes tyre, paditësi ka për qëllim që të frikësojë dhe dekurajojë gazetarët apo aktivistët nga raportimi dhe shprehja e opinionëve për çështje me interes publik duke i detyruar ata të kalojnë nëpër procese të gjata dhe të kushtueshme gjyqësore. Këto padi konsiderohen dhe duhet të trajtohen si abuzim i legjislacionit kundër shpifjes nga njerëzit dhe korporatat e fuqishme për të heshtur gazetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët.

Në dhjetor të vitit të kaluar qindra organizata ndërkombëtare i kanë rekomanduar Komisionit Evropian draftimin [e një Direktive kundër Padive SLAPP](#). Akterët relevantë në Kosovë duhet të bëhen pjesë e diskutimeve ndërkombëtare në këtë fushë dhe të sigurohen që paditë SLAPP të mos përdoren për të kufizuar të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetarëve dhe aktivistëve në vazhdimësi.

Përveç mbështetjes ndaj aktivistëve, ne shprehim shqetësimin tonë të thellë edhe për krijimin e trendit të përdorimit të këtyre padive ndaj aktivistëve dhe gazetarëve dhe e konsiderojmë cenim të lirisë së shprehjes, e me këtë edhe të demokracisë.

Liria e shprehjes është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, prandaj ne fuqishëm do të kundërshtojmë çfarëdo tendence për të shkelur këtë të drejtë themelore.

OJQ-të dhe aktivistët që mbështesin letrën:

Koalicioni Ad-Hoc përbëhet nga 75 OJQ dhe aktivistë/e: Lëvizja FOL, Flutura Kusari, Ardian Nrecaj, Adriatik Gacaferi, KCSF, GLPS, D4D, Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike, Fondacioni Kosovar i Arkitekturës, Docomomo Kosova, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore – CSGD, OJQ “Gjethi”, DokuFest, INPO, Çohu, IKD, TOKA, CEL Kosova, QKSS, Debate Center, Qendra për studime te avancuara FIT, Ekovizioni, Fondacioni Lumbardhi, Ecoz, Kosovo Environmental Network, KMDLNj, STIKK, Kosova – Women 4 Women, EC Ma Ndryshe, CHwB Kosova, Syri i Vizionit, Instituti për Liri dhe Drejtësi, Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP, Let’s Do It Kosova, IPKO Foundation, KFOS, Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), Qendra Termokiss, OJQ Rritu, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë – CRP/K, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, Qendra Multimedia, ECMI Kosova, D+, CIVIKOS, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), GUIDEKS (Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës), KADC, Shoqata e Intelektualëve të Pavarur në Deçan, Edhe RRjeti i Grave të Kosovës, GERMIN, Instituti GAP, NGO Ecopana, WWF Adria in Kosovo, Fondacioni Kosovar për Ndërmarrësi Sociale, Qendra Evropiane për Drejtat e Njeriut ne Strasbourg, OJQ “Euro-Ekologet”, Community Development Fund-CDF, INJECT, GAIA Kosova, Organizata Trentino con il Kossovo, Granit Gashi, Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS, YIHR KS, Birn Kosova, Internews Kosova, Kosid, Lets Do It Peja, Bunarfest, Ariana Qosaj Mustafa, Rrjeti e Edukatorëve Bashkëmohatar – PEN, Instituti i Prishtinës për Studime Politike-PIPS, KDI, PRO-Planning.